



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 179 Akti

Nr. 162 Vendimi

Tiranë, më 19.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në datën 18 qershor 2019, ora 16:00, në Pallatin e Koncerteve, salla 0, kati I, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Manjola Kajana**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, me funksion prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 3.10.2018, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues komisioner Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Në datën 13.12.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilën, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në datën 7.6.2019, Komisioni, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me rezultatet e hetimit kryesisht; (iii) të paraqesë pretendime/sqarime shtesë me afat 5 ditë nga data njoftimit; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Në datën 11.6.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit, të dërguara nga Komisioni në datën 07.06. 2019.
6. Në datën 12.6.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, dhe me anë të postës elektronike subjekti u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 18.6.2019, ora 16:00 në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.
7. Në datën 18.6.2019, u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues dhe shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 18.6.2019 për të rifilluar në datën 19.6.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Manjola Kajana, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI- në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. (***) , me shkresën nr. (***) prot., datë 4.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë së subjektit sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1¹, rezulton se subjekti Manjola Kajana e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.1.2017, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5², të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2008, me numër indeksi (***)

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi: në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Për pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

1. Për deklarimin në lidhje me apartament banimi me sip. 110.11 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, blerë në vitin 2013, nga shoqëria “A. A.” sh.p.k., në emër të K. dhe Manjola Kajana. Vlera: 41.300 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Me burim krijimi të deklaruar: kursimet e realizuara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortit të saj në vite dhe pjesërisht me kredi nga “BKT”-ja.

1.1 Për këtë aset, subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme me kusht kreditimi nr. (***), datë 29.4.2013.
- mandatdepozitimi në “Raiffeisen Bank”, datë 29.4.2013, shuma 4.310 euro, nga z. K. K..
- deklaratë noteriale, pjesë përbërëse e kontratës nr. (***), datë 29.4.2013, në të cilën shoqëria “A. A.” sh.p.k. konfirmon shlyerje totale të apartamentit nga pala blerëse K. dhe Manjola Kajana.
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. (***), datë 19.8.2014, për pasurinë apartament me sip. 97.8 m².
- kontratë kredie bankare nr. (***), datë 25.4.2013,
- ndryshime në kontratën e kredisë bankare nr. (***), datë 13.3.2014,

¹Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

²Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

- vërtetim nr. (***) prot., datë 18.1.2017, nga “BKT”-ja për çeljen e kredisë në datën 17.3.2014, në shumën totale 2.500.000 lekë.

1.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.2.1 Kjo pasuri është deklaruar në vitin 2013 si apartament në Yzberisht, Tiranë, me sipërfaqe 110.11 m², nga shoqëria “A. A.” sh.p.k. në emër të K. dhe Manjola Kajana, në shumën 43.100 euro, realizuar blerja pjesërisht me kursimet e realizuara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit të saj, në vite dhe pjesërisht me kredi nga “BKT”, në pjesë takuese të barabarta”.

1.2.2 ZVRPP-ja³ ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi me bashkëshortin e saj apartament me sip. 97.8 m², në Tiranë, me nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***)

1.2.3 Sipas kartelës së pasurisë, provë e administruar në praktikën e ZVRPP-së, rezulton se kjo pasuri është blerë për vlerën 43.100 euro.

1.2.4 Po sipas kësaj karte rezulton se kjo pasuri ka qenë e hipotekuar në favor të “BKT”-së për shumën 2.900.000 lekë, sipas kontratës së hipotekimit nr. (***) dhe më tej është liruar sipas deklaratës noteriale nr. (***) dhe pikës 7 të kontratës së shitjes me kusht.

1.2.5 Sipas kontratës së shitjes me kusht kreditimi nga banka, nr. (***), datë 29.4.2013, rezulton se shoqëria “A. A.” sh.p.k., i ka shitur subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj pasurinën e përshkruar në pikën 1.1, në shumën 43.100 euro. Në këtë kontratë është cilësuar edhe sipërfaqja e përbashkët 12.31 m².

1.2.6 Sipas kontratës së shitjes me kusht, çmimi i blerjes së apartamentit është *43.100 euro*. Po sipas kësaj kontrate, rezulton se çmimi kontraktor i kësaj pasurie është parashikuar për t’u ekzekutuar përkatësisht: (i) kësti i parë në shumën 4.310 euro, shumë që përbën 10 % të çmimit kontraktor, e cila do të paguhet në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate në llogarinë e hapur të noteres, në “Raiffeisen Bank”; (ii) kësti i dytë në shumën 17.420 euro që përbën 40 % të çmimit të përgjithshëm, vlerë e cila do të paguhet pas miratimit të kredisë, konkretisht në datën e disbursimit të saj, në llogarinë bankare të palës shitëse të hapur në “Alpha Bank”; dhe (iii) kësti i tretë i çmimit kontraktor në shumën 21.550 euro do të paguhet përmes një kredie bankare të miratuar dhe disbursuar nga “BKT”-ja, dega Fier. Si kusht i bërjes pronarë të kësaj pasurie, kjo kontratë ka parashikuar derdhjen e shumave nëpërmjet mandateve përkatëse.

1.2.7 Komisioni, me pyetësorin e datës 28.3.2019, e ka pyetur subjektin në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacionin justifikues lidhur me pagesat e kryera.

1.2.8 Në përgjigjen e dhënë subjekti ka depozituar:

- kopje të kontratës së shitjes nr. (***), datë 29.4.2013, si dhe mandatpagesës në shumën prej 4.310 (katër mijë e treqind e dhjetë) eurosh;
- kopje të mandatpagesës në shumën prej 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) eurosh;
- kopje të *statementit* nga “BKT”-ja e datës 17.3.2014 për kalimin e shumës prej 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekësh, si kredi në emër të z. K. K., si dhe kopje të *statementit* të “BKT”-së, datë 2.4.2019;
- mandat për derdhje të shumës prej 50 (pesëdhjetë) eurosh, datë 5.8.2013;
- mandat për derdhje të shumës prej 2000 (dymijë) eurosh, datë 10.6.2014;
- mandat për derdhje të shumës prej 1200 (një mijë e dyqind) eurosh, datë 25.6.2014;
- mandat për derdhje në shumën prej 20 (njëzet) eurosh, datë 16.7.2014;

³ Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, nr. (***) prot., datë 15.11.2018, në dosjen e Komisionit

- mandat për derdhje në shumën prej 3.02 eurosh, datë 16.7.2014.

1.2.9 Sipas akteve të depozituara ka rezultuar se në datën 29.4.2013, në “Raiffeisen Bank” është kryer pagesa për këstin e parë në masën 10 % të çmimit të apartamentit, shumë kjo e depozituar në llogarinë e noteres sipas kontratës së shitjes në datën 17.6.2013, në “Bankën Credit Agricole” në llogarinë e shoqërisë “A. A.” sh.p.k., me titull, *pagesë kësti nr. 2, është derdhur shuma 18.000 euro*. Në datën 17.3.2014 është bërë kalimi i shumës 2.461.150 lekë (nga shuma e përfituar 2.500.000 lekë), kredi e përfituar nga “BKT”-ja, e kaluar në llogarinë e shoqërisë “A. A.” sh.p.k., si dhe në vijim janë derdhur shumat përkatëse në datat 5.8.2013, 10.6.2014, 25.6.2014, 16.7.2014, 16.7.2014, që në tërësinë e tyre këto pagesa konfirmojnë shumën prej 43.100 eurosh për shlyerjen e kësaj pasurie.

1.2.10 Sipas deklaratës noteriale nr. (***) , datë 16.7.2014, provë e administruar në praktikën e ZVRPP-së, përfaqësuesi i shoqërisë “A. A.” sh.p.k, me cilësinë e shitësit të kësaj pasurie, ka deklaruar se ka marrë në dorëzim në masë të plotë dhe pa diferenca çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes me kusht.

1.2.11 Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka konfirmuar kontratën e energjisë elektrike për këtë pasuri, me nr. (***) , në instancën e Tiranës.

1.2.12 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimin e të ardhurave, administroi nga institucionet publike dhe private, si më poshtë:

- shkresën nr. (***)prot., datë 27.11.2018, të ZVRPP-së Tiranë;
- shkresën nr. (***)prot., datë 4.12.2018, të OSHEE-së;
- shkresën nr. (***)prot., datë 4.12.2018 të “BKT”-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur saj.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie, trupi gjykues, duke pasur parasysh faktet e dala dhe provat konkludoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe për rrjedhojë çmon se deklarimi i tij është i saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

1.3 Për deklaratimet lidhur me kursimet e krijuara nga paga e subjektit dhe bashkëshortit të saj ndër vite, si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie.

Nga aktet në dosjen e hetimit administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte martuar sipas aktit nr(***) , datë 18.7.2008, të Zyrës së Gjendjes Civile⁴. Në përlllogaritjet financiare, Komisioni ka përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit të përfituara prej fillimit të Shkollës së Magjistraturës dhe aktualisht⁵ (për shkak të vijueshmërisë së shlyerjes së kredisë), si dhe të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, të përfituara nga punësimi⁶ në Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës dhe aktualisht.

⁴ Referojuni informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nr. (***)prot., datë 27.11.2018, në dosjen e Komisionit.

⁵ Referojuni vërtetimit nr. (***) prot., datë 18.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës; vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 11.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së; vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. (***) prot., datë 11.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së; vërtetim nr. (***) prot/N.Z, datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së; vërtetim nr. (***) prot., datë 11.10.2016, nga ISSH Fier, në dosjen e ILDKPKI-së; vërtetim nga ISSH-ja Tiranë, datë 14.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶ Referojuni vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto nga DAR Durrës, për periudhën 2004–2006; tabelë përmbledhëse nga Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, për të ardhurat nga paga bruto dhe neto për periudhën tetor – dhjetor

1.3.1 Për deklaratimet lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet 2013 – 2014.

1.3.1.i Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.3.1.i.a Në deklaratën për “Vetting” subjekti kishte deklaruar: *“Të ardhura neto nga pagesa e bashkëshortit K. K. si konsulent ligjor pranë shoqërisë “A. C.” sh.p.k., për vitin 2013,2014 (me adresë lagjja “D.”, Burrel), në shumën 750.000 lekë”.*

1.3.1.i.b Në deklaratën për vitin 2013 subjekti kishte deklaruar shumën 600.000 lekë të ardhura nga punësimi i bashkëshortit në këtë shoqëri.

1.3.1.i.c Në deklaratën për vitin 2014 subjekti kishte deklaruar shumën 150.000 lekë të ardhura nga punësimi i bashkëshortit po në këtë shoqëri.

1.3.1.i.d Nga verifikimi i të dhënave të ISSH⁷, Komisionit i rezultoi se paga e bashkëshortit të subjektit kishte kaluar nëpërmjet bankës, ndërsa nuk rezultonin të ishin paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

1.3.1.i.e Mbi këtë konstatim Komisioni e ka pyetur⁸ subjektin dhe ka kërkuar që të depozitojë dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me burimin e ligjshëm të tyre.

1.3.1.i.f Në përgjigje e dhënë, subjekti ka deklaruar⁹ : *“...në lidhje me këtë marrëdhënie pune e cila ka zgjatur rreth një vit e pak muaj nga janari i vitit 2013 deri në mars të vitit 2014, bashkëshorti ka punuar si konsulent ligjor pranë shoqërisë “A. C.”... Pagesa është kryer rregullisht në Bankën “Societe Generale Albania”¹⁰. ... nga ana e bashkëshortit në fillim të vitit 2019 kur atij po i llogariteshin vitet e punës për efekt të vjetërsisë dhe përlllogaritjes së pagës me ndryshimet që pësoi legjislacioni për pagën në vendin e punës së tij si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, nuk i rezultonte si periudhë punësimi periudha nga janari 2013 deri më mars të vitit 2014, periudhë e cila përkon me periudhën e punësimit pranë kompanisë “A. C.” sh.p.k. Pasi ka kërkuar informacion për këtë situatë, bashkëshorti ka biseduar me ish-punëdhënësin i cili ka sqaruar se ka ndodhur një gabim njerëzor i kryer nga ana e kompanisë, pasi nuk ishin paguar kontributet dhe tatimi mbi të ardhurat për pagën e marrë nga bashkëshorti. Nga ana e bashkëshortit është kërkuar që nga kjo kompani dhe personat e ngarkuar të marrin përsipër përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e punës mes palëve, pasi nuk ka patur dijeni për një situatë të tillë ndodhur në kushtet kur paga është kaluar nëpërmjet “Societe Generale Albania”, dhe as nuk i ka shkuar ndërmend se mund të ndodhte një situatë e tillë. Kjo për faktin se nga punëdhënësit e mëparshëm bashkëshorti nuk kishte konstatuar situata të kësaj natyre. Në muajin prill të vitit 2019, nga ana e shoqërisë “A. C.” sh.p.k, me nr. NIPT (***) është kryer pagesa e tatimit në burim mbi pagën e kryer gjatë vitit 2013 dhe 2014 në vlerat përkatëse 139.008 lekë dhe 38.538 lekë¹¹”.*

Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka depozituar kontratën individuale të punës, datë 5.1.2013.

2006; janar – gusht 2007; Vërtetim nga B.-E. J., datë 3.10.2016, për periudhën e punësimit shtator 2007 – maj 2011; Vërtetim punësimi nga PËC, datë 14.10.2016, për periudhën 1.6.2011 – 30.11.2012; vërtetim nga shoqëria “A. – C.”, nr. (***) prot., datë 17.1.2017, për periudhën 5.1.2013 – 31.3.2014; vërtetim nga Gjykata Administrative e Apelit, nr. (***) prot., datë 12.1.2017, për periudhën 10.06.2015 – 31.12.2016.

⁷ Shkresë nr. (***) prot., datë 23.11.2018, nga ISSH-ja, ku për shtetasin K. K., rezulton e pasiguruar periudha dhjetor 2012 – maj 2014.

⁸ Referojuni pyetësorit, datë 23.4.2019, në dosjen e Komisionit.

⁹ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 9, të pyetësorit datë 23.4.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Bashkëlidhur *statement* bankar ku ka kaluar paga, kontratën individuale të punës të datës 5.1.2013, vërtetimin e datës 20.02.2013, si dhe vërtetimin e kësaj shoqërie, datë 17.1.2017, dorëzuar bashkëlidhur deklaratës “Vetting”.

¹¹ Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve do të gjeni dhe dy urdhërpagesat e përmendura gjithsej në katër faqe.

1.4 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe burimin e të ardhurave, administroi nga institucionet publike e private, si më poshtë:

- shkresën nr. (***) prot., datë 23.11.2018, nga ISSH-ja;
- shkresën nr. (***) prot., datë 24.12.2018, nga “Societe Generale Albania.

- Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Sipas kontratës individuale të depozituar rezulton se kontributet mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit do të derdreshin nga punëdhënësi. Sipas *statement* bankar Komisioni konstatoi se pagat e bashkëshortit të subjektit në shumën 50.000 lekë ishin kaluar çdo muaj në sistemin bankar nga punëdhënësi, ndërsa u konstatua se nuk ishin paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhë punësimi. Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit depozitoi pagesat e kryera nga punëdhënësi në datën 5 prill 2019, sipas urdhërpagesave mbi tatimin e mbajtur në burim, për periudhën tatimore dhjetor 2014 dhe korrik 2015, përkatësisht në shumat 139.008 lekë dhe 38.538 lekë. Në këto kushte Komisioni i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare.

1.5 Për deklarimin e kredisë së përfituar në shumën 2.500.000 lekë si burimi tjetër për krijimin e kësaj pasurie

1.5.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.5.2 Komisioni, lidhur me këtë kredi, i ka kërkuar informacion “BKT”-së¹².

- Me shkresën nr. (***) prot., datë 4.12.2018, “BKT”-ja ka konfirmuar se shtetasi K. K. dhe subjekti i rivlerësimit janë bashkëkredimarrës në shumën 2.500.000 lekë. Njëkohësisht, banka ka vënë në dispozicion edhe praktikën përkatëse lidhur me këtë kredimarrje.
- Nga praktika e kredisë rezulton se me kontratën nr. (***), datë 25.5.2013, nënshkruar midis “BKT”, dega Fier dhe bashkëkredimarrësve, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, është parashikuar përfitimi i saj në shumën 2.900.000 lekë, bazuar në: ligjin nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar; VKM-në nr. 600/2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politik”; udhëzimin nr. 6257/2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; si dhe udhëzimin nr. 10240/1, datë 17.10.2008, e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, marrëveshjes tripalëshe, datë 18.2.2009, etj.
- Më tej, me kontratën e hipotekimit nr. (***), datë 25.6.2013, është nënshkruar midis “BKT”-së, dega Fier, përfaqësuesit të shoqërisë ndërtimore të kësaj pasurie, si dhe bashkëkredimarrësve, hipotekimi i saj/pasurisë në favor të bankës.
- “BKT”-ja në informacionin e dhënë konfirmon saktësisht se për këtë kredi është vendosur *kolateral* apartamenti me sip. 97.8 m² (i përshkruar në pikën 1 më sipër), me nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), Yzberisht, Tiranë. Kredia rezulton e disbursuar në datën 17.3.2014.
- Me aneksin e çeljes dhe përdorimit të kredisë, datë 25.6.2013, është cilësuar se kreditimi do të përdoret nga kredimarrësi për blerje shtëpie.
- Lidhur me përfitimin e kësaj kredie, me shkresën nr. (***) prot., datë 21.12.2012, Bashkia Fier, ka përcjellë (për llogari të praktikës bankare) listën e miratuar me Vendim të Këshillit

¹² Referojuni shkresës nr(***)prot., datë 15.11.2018, në dosjen e Komisionit.

të Bashkisë nr. (***) , datë 30.10.2012, për familjet e pastreha, në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. K. K., renditet i 60-ti, me përshkrimin “*familje e pastrehë, jeton në banesë me qira, sipas Udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008*”.

- Me ndryshimet e kontratës së kredisë bankare, nr. (***) , datë 13.3.2014, nënshkruar midis përfaqësuesve të “BKT”-së, dega Fier, përfaqësuesit të shoqërisë ndërtimore të kësaj pasurie, si dhe bashkëkredimarrësve, rezulton se kredia nuk është disbursuar sipas kontratës së nënshkruar në datën 25.5.2013 për shkak të ezaurimit të kuotave të Bashkisë Fier për përfituesit nga programi i kreditimit me kushte lehtësuese nga shteti, dhe për pasojë palët kanë pranuar ndryshimet përkatëse të cilat kanë konsistuar në ndryshimin e shumës së kredisë nga 2.900.000 lekë në 2.500.000 lekë, me afat 240 muaj.
- Sipas praktikës bankare rezulton se kredia është disbursuar në favor të kredimarrësve në datën 17.3.2014, në shumën 2.500.000 lekë, dhe po në këtë datë është kaluar në favor të shoqërisë ndërtimore me cilësinë e shitësit të kësaj pasurie.
- Komisioni, në analizë të këtyre dokumenteve, ka pasur paqartësi në mënyrën e aplikimit dhe përfitimit të kësaj kredie, dhe për rrjedhojë ka pyetur¹³ subjektin, si dhe ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit mbështetës.
- Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse¹⁴, ka depozituar kopje të skanuar të kontratave të kredisë nr. (***) , datë 25.4.2013, nr. (***) , datë 13.3.2014, si dhe kopjen e plotë të praktikës dokumentare të vënë në dispozicion nga banka¹⁵.
- Nga aktet e depozituara rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.4.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, fillimisht ka aplikuar si familje e pastrehë në qytetin e Fierit duke depozituar dokumentacionin përkatës, ku ndër të tjera, konfirmohet që ai dhe subjekti i rivlerësimit kanë qenë banues në këtë qytet që prej vitit 2010¹⁶, dhe në vijim ka nënshkruar edhe kontratën për përfitimin e kredisë në shumën 2.900.000 lekë.
- Sipas nenit 4/a të ligjit nr. 9232/2004, është parashikuar se familjet që klasifikohen për t’u trajtuar me programe sociale të strehimit, miratohen në plotësim të disa kriterëve, ku ndër të tjera, duhet që aplikantët të mos kishin në pronësi një banesë.
- Referuar listës së miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. (***) , datë 30.10.2012, rezulton se bashkëshortit të subjektit i ishte miratuar kredia si i pastrehë.
- Ndërsa, Komisionit, nga hetimi administrativ i pasurisë nr. 2, i ka rezultuar se subjekti, bashkëshorti dhe vjehri i saj, kanë qenë bashkëpronarë të saj sipas kontratës përfundimtare të shitjes, datë 30.6.2012, nënshkruar me Entin Kombëtar të Banesave, si pasojë e statusit të pastrehë që gëzonte më parë vjehri i subjektit në qytetin e Durrësit, që prej vitit 1996.
- Sipas vërtetimit të “BKT”-së, datë 20.5.2019, konfirmohet se bashkëshorti i subjektit nuk është trajtuar si kredimarrës në skemën e kredive të pastreha, por është trajtuar si kredimarrës me norma normale interesi, sa Bono e Thesarit të vitit aktual, si pasojë e ezaurimit të kuotave të Bashkisë Fier për përfituesit nga programi i kreditimit me kushte lehtësuese nga shteti.
- Komisioni, për të qartësuar përfitimin e kredisë në përputhje me legjislacionin e parashikuar në kontratën e nënshkruar, i kërkoi shpjegime subjekti të rivlerësimit se dukej

¹³ Referojuni pyetësorit datë 16.5.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Referojuni përgjigjes datë 21.5.2019 në tekst të *e-mail*-it, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 20.5.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Referuar Vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 25.2.2013, bashkëngjitur pyetësorit të subjektit.

se kishte aplikuar në kundërshtim me ligjin nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, me VKM-në nr. 600/2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politik”, si dhe aktet e tjera dalë në zbatim të këtij ligji për të përfituar statusin “i pastrehë”, pasi njëkohësisht ajo ishte bashkëpronare me bashkëshortin dhe vjehrrin e saj në pasurinë e privatizuar nga Enti Kombëtar i Banesave në qytetin e Durrësit, me kontratën nr. (***) , datë 30.6.2012, dhe për pasojë, dukej se subjekti kishte nënshkruar në kundërshtim po me këtë legjislacion edhe kontratën nr. (***) , datë 25.5.2013, si dhe kontratën e hipotekimit nr. (***) , datë 25.6.2013, dhe për këtë i kërkoi të japë shpjegime.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se banesa në qytetin e Durrësit ku ajo ka qenë bashkëpronare së bashku me bashkëshortin dhe vjehrrin e saj ka qenë një banesë me sipërfaqe rreth 40 m², në të cilën bashkëshorti dhe prindërit e tij kanë jetuar për një kohë të gjatë kundrejt pagesës së një qiraje shtetërore. Në kohën e privatizimit të saj në vitin 2012 atje, ka sqaruar subjekti, jetonte vetëm i vjehri, ndërkohë që bashkëshorti, djali dhe vetë ajo kanë jetuar në shtëpi me qira, **për shkak të sipërfaqes së vogël dhe gjendjes së amortizuar të banesës në bashkëpronësi në qytetin e Durrësit.**

Po ashtu, subjekti ka sqaruar se bashkëshorti i saj kujton se ka bërë kërkesë dhe ka dorëzuar dokumentacionin, duke çmuar se kishte të drejtë të përfitonte nga programet sociale që ofronte Bashkia e Fierit sipas germës “b”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, në të cilën parashikohej se përfitues mund të ishin edhe familjet që “zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale”. ...**sipërfaqja prej 40 m², dukshëm (për shkak të strukturës së saj, një dhomë, ambient gatimi, tualet, ballkon) nuk është e përshtatshme për të banuar katër persona**, pra, një familje e re me fëmijë të vogël, së bashku me prindin e njërit bashkëshort... *“dhe, për këtë arsye, prej kohësh jetonim me qira, pra bashkëshorti, djali dhe unë...”*

Subjekti ka sqaruar gjithashtu se pavarësisht se kjo kontratë, pra, kontrata nr. (***) , datë 25.6.2013, është nënshkruar konform ligjit nga “BKT”-ja, dega Fier, dhe nga bashkëkredimarrësit. Sipas subjektit: *“Ne nuk kemi përfituar kredinë sipas saj, si rrjedhojë, ajo nuk ka pasqyruar asnjë pasojë financiare apo juridike.*

Unë dhe bashkëshorti nuk kemi përfituar asnjë shumë apo send të paluajtshëm, pra, pasuria jonë nuk është shtuar për efekt të kësaj kontrate dhe interesi publik nuk është dëmtuar prej këtij akti të paekzekutuar dhe të shfuqizuar, edhe pse në thelb ai ishte në përputhje të plotë me ligjin dhe aktet nënligjore mbi të cilat ishte lidhur.

*Kredia që ka shërbyer për pagimin pasurisë së paluajtshme: apartament banimi në zonën Yzberisht, Tiranë, të vetmen banesë që ne kemi në pronësi, është përfituar mbi bazën e kontratës nr. (***) , datë 13.3.2014, datë në të cilën është bërë edhe disbursimi i kredisë në favor të kredimarrësve. Kjo kredi, siç e ka sqaruar edhe vetë “BKT”-ja në vërtetimin e saj, është lidhur me norma të zakonshme interesi, duke mos qenë përfitues nga programi i kreditimit me kushte lehtësuese nga shteti.”*

- Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Nisur nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, trupi gjykues arrin në konkluzion se miratimi i kredisë në emër të bashkëshortit të subjektit, është kryer konform parashikimit ligjor të VKM-së nr. 814, datë 3.12.2004, në të cilën, ndër të tjera, thuhet se përfitojnë kredi familjet që nuk disponojnë banesë në pronësi ose

banojnë nën normat e strehimit. Në kushtet kur sipërfaqja e banesës së privatizuar në qytetin e Durrësit ka qenë më e vogël se ajo e duhur në proporcion me numrin e frymëve të anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, edhe kredia ka qenë plotësisht e lejuar për t'u përfituar. Në përfundim, Komisionit i rezultoi se subjekti ka përfituar kredinë me norma të zakonshme interesi.

- ✓ Për sa sipër, trupi gjykues arrin në konkluzion se kredia në shumën 2.500.000 lekë është përfituar konform legjislacionit në fuqi.
- ✓ Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare për burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë, duke përlogaritur kursimet e krijuara nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj, të ardhurat nga kredia, si dhe shpenzimet e kryera. Në konkluzion Komisionit i rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

2. Për deklarinë në lidhje me apartamentin me sip. 41.9 m², ap. (***), shk. (***), kati i dytë, ndodhur në lagjen nr. (***), Plazh, Durrës, përfituar nëpërmjet privatizimit nga Enti Kombëtar i Banesave, në qershor të vitit 2012, në bashkëpronësi me bashkëshortin K. K. dhe vjehrrin Th. K., në pjesë të barabarta. (Subjekti ka deklaruar: “...blerë me të ardhura të kursyera ndër vite nga pagat e mia, bashkëshortit dhe vjehrrit, z. Th. K.”). Shitur në muajin dhjetor të vitit 2012. Vlera e apartamentit: 473.497 lekë. Pjesa takuese: 33.33%.

2.1 Për këtë aset, subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Kontratë shitje përfundimtare nr. (***), datë 30.6.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Enti Kombëtar të Banesave dhe palëve blerëse Th. K., K. K., Manjola Kajana, të një apartamenti me sip. 41.9 m² në shumën 473.497 lekë, me vendndodhje në Durrës.

2.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ZVRPP-së Durrës¹⁷. Apartamenti është i shitur”.

2.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

2.3.1 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012: “Apartament, me sip. 49.1 m², datë 30.6.2012, ndodhur në lagjen nr. (***), Durrës, si privatizim në emër të Th. K., K. K., Manjola Kajana, nga EKB-ja në pjesë të barabarta, në shumën 473.497 lekë. Burimi i krijimit: kursimet e pagës së subjektit dhe bashkëshortit.”

2.3.2 Për sa sipër dukej se kishte mospërputhje midis deklaramit të bërë në deklaratën “Vetting” – se për burimin e kësaj pasurie janë përdorur edhe kursimet ndër vite të vjehrrit të subjektit – me deklarimin e bërë në deklaratën periodike për vitin 2012, se për burimin e kësaj pasurie janë përdorur kursimet e pagës së subjektit dhe bashkëshortit të saj. Për këtë subjektin i është kërkuar të japë shpjegime.

- Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë fakt të konstatuar nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar: “Ky është një lapsus i bërë nga ana jonë në deklaratën periodike për vitin 2012, pasi deklarimi i saktë është ai i bërë në deklaratën “Vetting”. Siç kam shpjeguar edhe më sipër, vjehrrin im banonte në këtë banesë dhe ka dhënë kontributin e tij.”

- ✓ Trupi gjykues pas shpjegimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, krijon bindjen se nuk ka dyshime lidhur me deklarimin e burimit të kësaj pasurie.

¹⁷ Referuar dokumentacionit bashkëngjitur shkresës nr. (***), prot., datë 2.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së (aneks 28).

2.4 Nga aktet e administruara rezulton se kjo pasuri është blerë me kontratën e shitjes përfundimtare nr. (***) , datë 30.6.2012, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe shtetasve Th. K., K. K., dhe Manjola Kajana.

2.5 Në pyetësonin e datës 8.05.2019 Komisioni i ka kërkuar subjektin të depozitojë dokumentacionin e plotë mbi mënyrën e përfutimit të kësaj pasurie.

2.6 Në përgjigjen e datë 15.5.2019 subjekti ka dhënë shpjegime, si dhe ka depozituar disa dokumente¹⁸.

2.7 Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se familja e z. Th. K. sipas vendimit nr. (***) , datë 31.1.1990, të Këshillit të Lagjes nr. (***) , Durrës, ka ndryshuar banimin dhe është vendosur të banojë në banesën në pallatin “V.” të lagjes nr. (***) , Durrës, që në muajin dhjetor të vitit 1991. Sipas shkresës nr. (***) prot., datë 13.5.2019, të Bashkisë Durrës, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur kësaj shkrese rezulton se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, vjehri i saj, z. Th. K., që në vitin 1995 figuron i regjistruar në listën e qytetarëve (me nr. rendor 381), të cilët janë me banim të përkohshëm në ndërtesa që nuk hyjnë në fondin e ndërtesave si hotele, shkolla, konvikte dhe qendra administrative. Me vërtetimin e datës 4.5.1996, të Bashkisë Durrës, rezulton se shtetasi Th. K. ka fituar statusin “i pastrehë”, sipas VKM-së nr. 49, datë 29.1.1993. Nga aktet e depozituara rezulton se shtetasi Th. K. ka jetuar në këtë pasuri me kontrata qiraje me cilësinë e qiramarrësit, nga Ndërmarrja Komunale, Plazh, Durrës, për të cilën sipas librezave ka paguar për periudhën 1997 – 2000. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur, shkresës nr. (***) prot., datë 13.5.2019, të Ndërmarrjes Komunale, Plazh, Bashkia Durrës, rezulton se z. Th. K. është strehuar në këtë mjedis nga viti 1993 deri kur në bazë të VKM-së nr. 256, datë 23.3.2011, këto mjedise janë privatizuar. Në listat që i bashkëlidhen VKM-së nr. 256, datë 23.3.2011, në pikën 12 të saj, nën emërtimin “Lista emërore e personave që banojnë në pallatin “V.” Plazh, Durrës, Lagja nr. (***) , z.k. (***)”, në numrin rendor 87, pasqyrohet emri i shtetasit Th. K. .

2.8 Nga dokumentacioni rezulton se ky privatizim është kryer me Entin Kombëtar të Banesave sipas përbërjes familjare në muajin mars për vitin 2011, ku pjesë përbërëse janë Th. K., vjehri i subjektit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj si dhe djali i mitur i subjektit.

2.9 Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me aftësinë paguese të kësaj pasurie, duke përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2012, deri në momentin e blerjes së pasurisë.

¹⁸ Kopje të skanuar të letërnjoftimit të z. Th. K., ku në faqen nr. 6 të tij gjendet shënimi për ndryshimin e banimit sipas Vendimit nr. 12 datë 31.01.1990; kopje të skanuar të letërnjoftimit të znj. M. B., ku në faqen nr. 6 të tij gjendet shënimi për ndryshimin e banimit sipas vendimit nr. 12, datë 31.1.1990; kopje të skanuar të vërtetimit nr. (***) , datë 13.5.2019 i Ndërmarrjes Komunale Plazh, Bashkia Durrës, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur këtij vërtetimi; kopje të skanuar të librezës së qirave në emër të z. Th. K. për banesën (***) , për vitet 1997 – 2000; kopje të skanuar shkresës nr. (***) prot., datë 13.5.2019 e Bashkisë Durrës, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur kësaj shkrese; kopje të skanuar të shkresës nr. (***) prot., datë 14.5.2019 të Entit Kombëtar të Banesave dhe të kërkesës drejtuar këtij enti; praktikën e plotë dokumentare të kontratës së shitjes, datë 30.6.2012, nr. (***) , lidhur ndërmjet palëve, Entit Kombëtar të Banesave të administruar nga Enti Kombëtar i Banesave sipas shkresës me nr. (***) prot., datë 13.5.2019; kopje të urdhërpaguesës nga “Credins Bank” të z. Th. K., datë 21.5.2012; kopje të skanuar të vërtetimit nr. (***) prot., datë 13.4.2012, të Bashkisë Durrës; kopje të skanuar të vërtetimit me nr. (***) prot., datë 11.4.2012 i Ndërmarrjes Komunale Plazh; VKM-ja nr. 49, datë 29.1.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”; VKM-ja nr. 256, datë 23.3.2011, “Për kalimin e disa pasurive të ndodhura në zonën kadastrale nr. (***) të Bashkisë Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës të qarkut të Durrësit”.

- ✓ Trupit gjykues, pas hetimit të kryer dhe rezultateve të konstatuara nga analiza financiare, i ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar, si dhe se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për blerjen e pasurisë së luajtshme.

3. Për deklarimin në lidhje me shitjen e apartamentit me sip. 41.9 m², ap. (*) , shk. (***) , kati i dytë, ndodhur në lagjen nr. (***) , Plazh, Durrës (të përshkruar në pikën 2 më sipër), shitur në muajin dhjetor të vitit 2012, në bashkëpronësi me bashkëshortin K. K. dhe vjehrrin Th. K., në pjesë të barabarta. Vlera: 1.700.000 lekë. Pjesa takuese: 33.33%.**

3.1 Për këtë aset subjekti, në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, ka paraqitur:

- Kontratë shitblerjeje nr(***) , datë 6.12.2012, nënshkruar ndërmjet palëve shitëse Th., K. dhe Manjola Kajana dhe palës blerëse N. H., të apartamentit me sip. 41.9 m², regjistruar me nr. (***) , në vlerën 1.700.000 lekë.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor të pasurisë së regjistruar në emër të Th., K. dhe Manjola Kajana me nr. (***) , lëshuar në datën 7.9.2012, si dhe harta treguese e regjistrimit.
- Mandattransferimi i shumës 1.700.000 lekë, datë 6.12.2012, pranë “Societe Generale Albania”, me përshkrimin “kalim shume për blerje apartamenti”.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor të pasurisë së regjistruar në emër të Entit Kombëtar të Banesave, nr. (***) , lëshuar në datën 9.9.2011, shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit, formularin e llogaritjes së treguesve të shitjes së banesës dhe formularin i llogaritjes së çmimit të apartamentit nr. (***) , me vendndodhje në lagjen nr. (***) , Durrës.
- Vërtetim nr. extra prot., datë 16.4.2012, lëshuar nga Bashkia Durrës për gjendjen familjare në vitin 2011, sipas certifikatave familjare dhe regjistrimit kombëtar të shtetasit Th. K., me përbërje prej 4 personash. Bashkëlidhur ndodhen certifikatat familjare të Th. K. dhe K. K..
- Relacion mbi llogaritjen e pagesës së vlerës së trullit për kontratën e z. Th. K. .
- Plani i vendosjes së apartamentit.
- Urdhërshirimi bankar në “Credins Bank”, datë 21.5.2012.

3.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ZVRPP-së Durrës dhe DPPPP-së. Apartamenti është i shitur”.

3.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

3.3.1 Në deklaratën për vitin 2012 është deklaruar shitja e kësaj pasurie si dhe të ardhurat në shumën 1.700 000 lekë të përfituara prej saj.

3.3.2 Sipas kartelës së pasurisë¹⁹ rezulton se ky apartament është rivlerësuar në vlerën 3.123.226 lekë.

3.3.3 Sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 6.12.2012, kjo pasuri i është shitur shtetasës N. H., në vlerën 1.700.000 lekë. Rezulton se pagesa është kryer me transfertë bankare në datën 6.12.2012, në shumën 1.700.000 lekë, nga blerësja e kësaj pasurie në “Societe Generale Bank”, për bashkëshortin, K. K. .

3.3.4 Komisioni në lidhje me përdorimin e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie e ka pyetur subjektin, e cila ka deklaruar²⁰: “... paratë e përdorura për arredimin e shtëpisë janë kryesisht të ardhurat e depozituara në “Societe Generale Bank” pas shitjes së një apartamenti në zonën e lagjes nr. 13, Durrës, për vlerën prej 1.700.000 lekësh. Shumat e parave janë tërhequr përgjatë vitit 2013 nga momenti që ne kemi filluar të hyjmë në marrëdhënie për të blerë

¹⁹ Referojuni aneksit nr. 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 8, të pyetësorit nr. 3, datë 23.4.2019, në dosjen e Komisionit.

apartamentin ku jetojmë aktualisht në Yzberisht, Tiranë, dhe deri nga fundi i vitit 2013, dhe e kemi rregulluar pak nga pak dhe mobiluar përfundimisht në fund të vitit 2013.”

3.3.5 Rezulton se subjekti ka deklaruar arredimin e pasurisë nr. 1 të përshkruar më sipër në deklaratën për vitin 2013, si dhe në pyetësin standard të Komisionit, në shumën 1.400.000 lekë.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit administrativ të kryer, arrin në konkluzion se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me *statementin* bankar për pagesën e shitjes së apartamentit²¹.

4. Për deklarimin në lidhje me autoveturën tip “Volkswagen Passat”, me targë (*)**, blerë në datën 22.10.2016, regjistruar në emër të z. Manjola Kajana (regjim i përbashkët martesor, në bashkëpronësi me bashkëshortin). Burimi i deklaruar i krijimit: “...kursimet nga pagat e mia dhe të bashkëshortit, si dhe nga shitja e autoveturës “Ford Focus”, me targë (***)”. Vlera e automjetit: 450.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

4.1 Për këtë aset, subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Kontratë shitjeje pasuri e luajtshme nr. (***) , datë 22.10.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse E. K. dhe palës blerëse Manjola Kajana, të automjetit tip “Volkswagen Passat”, në vlerën 450.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Leje qarkullimi nr. (***) , e automjetit me targë (***) , në pronësi të znj. Manjola Kajana.
- Çertifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targë (***) , regjistruar në pronësi të 4.1 Manjola Kajana sipas kontratës së blerjes nr. (***) , datë 27.10.2016.

4.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e DPSHTRR-së*”.

4.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

4.3.1 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2016, me të njëjtin burim krijimi.

4.3.2 Komisioni, me shkresën nr. (***) prot., datë 15.11.2018, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me këtë automjet.

4.3.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 21.11.2018, ka konfirmuar automjetin me targë (***) , në pronësi të znj. Manjola Kajana.

4.3.4 Nga aktet e administruara rezulton se kjo pasuri është blerë me kontratë shitjeje pasuri e luajtshme nr. (***) , datë 22.10.2016, në shumën 450.000 lekë, nga shitësi E. K., shumë e likuiduar sipas kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.

4.3.5 Po nga aktet e administruara rezulton se me kontratë shitblerjeje automjeti nr. (***) Kol, datë 26.8.2015 ndërmjet shitësit K. K. dhe blerësit B. D., është shitur autovetura “Ford Focus”, me targë (***) në vlerën 2.500 euro.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit administrativ të kryer, arrin në konkluzion se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

5. Për deklarimin në lidhje me shitjen e autoveturës “Ford Focus”, me targë (*)**, në vitin 2015. Vlera: 2.500 euro. Pjesa takuese: 50%.

5.1 Për këtë aset, subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

²¹ Shkresë Nr. prot. (***) datë 24.12.2018 nga Societe Generale Albania Bank, në dosjen e Komisionit.

- Kontratë shitblerjeje automjeti nr. (***) , datë 26.8.2015, nënshkruar ndërmjet palës shitëse K. K. dhe palës blerëse B. D., të automjetit “Ford Focus”, me targë (***) në vlerën 2.500 euro.

5.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie, është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e DPSHTRR-së. Automjeti është i shitur*”.

5.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

5.3.1 Kjo pasuri (e blerë) është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklaratën për vitin 2011.

5.3.2 Komisioni me shkresën nr. (***) prot., datë 15.11.2018, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me këtë automjet.

5.3.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 21.11.2018, ka konfirmuar shitjen e këtij automjeti.

5.3.4 Nga aktet e administruara rezulton se ky automjet është shitur me kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 26.8.2015, lidhur ndërmjet shitësit K. K. dhe blerësit B. D., në shumën në vlerën 2.500 euro.

5.3.5 Rezulton se automjeti është blerë nga shtetasi K. K. në vitin 2011 në vlerën 200.000 lekë, me kontratë shitblerjeje nr. (***) , datë 7.11.2011, nga shtetasi H. H. .

5.3.6 Të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie të luajtshme janë deklaruar *cash* në vitin 2015, të cilat janë përdorur për blerjen e automjetit “Volkswagen Passat” në vitin pasardhës.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer dhe rezultateve të konstatuara nga analiza financiare, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar, si dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për blerjen e pasurisë së luajtshme.

6. Për deklarimin në lidhje me shitjen e autoveturës “Ford Escort”, me targë (*) , në vitin 2009, në vlerën 120.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

6.1 Për këtë aset, subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Kontratë shitblerjeje automjeti nr. (***) , datë 9.6.2009, nënshkruar ndërmjet palës shitëse K. K. dhe palës blerëse V. Sh., të automjetit “Ford Escort”, me targë (***) , në vlerën 120.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim origjinali nr. (***) rep., datë 24.10.2016.

6.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

6.2.1 Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2008 subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë automjet, në shumën 95.000 lekë.

6.2.2 Sipas kontratës së shitblerjes²² nr. (***) , datë 11.5.2007, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri në shumën 95.000 lekë nga shtetasi A. B. .

6.2.3 Më tej me kontratën e shitblerjes²³ nr. (***) , datë 9.6.2009, bashkëshorti i subjektit ia ka shitur këtë automjet shtetasit V. Sh. në shumën 120.000 lekë.

²² Referojuni dokumentacionit bashkëngjitur përgjigjes nr. (***) prot., datë 21.11.2018 të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

²³ Referuar kontratës së depozituar në përgjigje të pyetjes 3 të pyetësorit datë 23.4.2019, në dosjen e Komisionit.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, arrin në konkluzion se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

7. Për deklarimin në lidhje me blerjen e letrave me vlerë për 36 muaj, në formën e obligacioneve të thesarit, në Bankën e Shqipërisë, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Manjola Kajana (regjim i përbashkët martesor, në bashkëpronësi me bashkëshortin), në vlerën 1.500.000 lekë, në vitin 2015. Burimi i krijimit: “...kursime nga pagat e mia dhe të bashkëshortit ndër vite”. Pjesa takuese: 50%.

7.1 Për këtë blerje letrash me vlerë subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Vërtetim mbi shpalljen fitues të klientes Manjola Kajana në “Raiffeisen Bank”, të ankandit numër (***) për blerje Obligacione të Thesarit në vlerën 1.500.000 lekë. Data e emëtimit 5.10.2015, datë maturimi 5.10.2018.
- Kërkesë për blerje letrash me vlerë, afat 36 muaj, të shumës 1.500.000 lekë.

7.2 ILDKPKI-ja në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank””.

7.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

7.3.1 Në dosjen e ILDKPKI-së është administruar vërtetim mbi shpalljen fitues, dokument nga “Raiffeisen Bank”, për vlerën 1.500.000 lekë, në emër të znj. Manjola Kajana.

7.3.2 Në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank”²⁴, është kthyer nga Banka e Shqipërisë fondi i bllokuar i bonove të thesarit prej 2.000.000 lekësh; kjo shumë është përdorur për blerje obligacionesh në datën 29.9.2015.

7.3.3 Nga hetimi i kryer rezultoi se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. (***) prot., datë 20.11.2018, konfirmon investimin në bono thesari nga subjekti i rivlerësimit, në shumën 1.500.000 lekë.

- ✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, arrin në konkluzion se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

8. Për deklarimin në lidhje me gjendje llogarie rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në datën 20.1.2017. Burimi i krijimit: “...kursimet nga pagat e mia dhe të bashkëshortit dhe overdraft në shumën 100.000 lekë”. Shuma: 608.825,82 lekë. Pjesa takuese: 50%.

8.1 Për këtë gjendje llogarie subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Nxjerrje e llogarisë në emër të Manjola Kajana pranë Raiffeisen Bank, për periudhën 20.1.2016 - 20.1.2017. Llogaria është e lidhur me një overdraft me limit 100.000 lekë, afat deri më 7.3.2020. Balanca e llogarisë në vlerën 508.825 lekë. Shuma disponibël total në llogari 608.825 lekë.

8.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie, është shprehur: “Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank””.

²⁴ Shkresë nga Raiffeisen Bank nr. (***)Prot., datë 20.11.2018, në dosjen e Komisionit.

8.3.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se Raiffeisen Bank, me shkresën nr. (***) prot., datë 20.11.2018 konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje 508.825,82 lekë, në datën 20.1.2017 dhe *overdraft*-in me limit 100.000 lekë.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, arrin në konkluzion se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

9. Për deklarimin në lidhje me gjendjen në depozitën bankare në “Credins Bank”, në emër të z. K. K. (bashkëshorti), në shumën: 1.666,25 euro. Pjesa takuese: 50%.

9.1 Për këtë depozitë subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Lëvizjet e llogarive në emër të K. K., pranë Credins Bank, gjatë periudhës 6.8.2009 – 19.1.2017. Gjendja në llogarinë nr. (***), në datë 19.1.2017, në shumën 1.666,25 lekë.

9.2 ILDKPKI-ja në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Credins Bank”*”.

9.3 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se “Credins Bank”, me shkresën nr. (***) prot., datë 1.2.2019, konfirmon depozitën në emër të znj. K. K. dhe gjendjen e saj në shumën 1.666,25 euro.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, arrin në konkluzion se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

10. Për deklarimin në lidhje me gjendje llogarie rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në datën 20.1.2017, në emër të K. K. . Burimi i krijimit: “...kursimet nga pagat e mia dhe të bashkëshortit”, në shumën 68.939,29 lekë. Pjesa takuese: 50%.

10.1 Për këtë depozitë subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Nxjerrje llogarie në emër të K. K., në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 20.1.2016 – 20.1.2017. Gjendja në llogari: 68.939 lekë.

10.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “*Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”*”.

10.3 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. (***) prot., datë 20.11.2018, konfirmon llogarinë e pagës në emër të znj. K. K., me gjendje: 68.929,29 lekë.

✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, arrin në konkluzion se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

11. Për deklarimin në lidhje me detyrimin e përbashkët të kredisë në “BKT” (kredimarrës: Manjola Kajana dhe K. K.), për blerje apartamenti në shumën 2.500.000 lekë, sipas kontratës së kredisë bankare nr. (*), datë 13.3.2014, me datë fillimi detyrimi 13.3.2014 dhe me afat mbarimi 240 muaj (prill 2034), me normë interesi “Bono thesari 1-vjeçare”; kësti mujor: 13.238,51 lekë në muaj. Shuma e mbetur e detyrimit në datën 19.1.2017 është: 2.236.415,85 lekë²⁵.**

²⁵ Për këtë kredi është argumentuar në pasurinë nr. 1

11.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “BKT”-së”*.

11.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se “BKT”-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 4.12.2018 konfirmon detyrimin e mbetur për këtë kredi me gjendje 2.236.415,85 lekë.

- ✓ Trupi gjykues, pas hetimit të kryer, arrin në konkluzion se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “BKT-së”.

12. Për deklarin në lidhje me marrëveshjen për përdorimin e kartës individuale të kreditit, Master Card, me “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Manjola Kajana, lidhur në datën 17.3.2015, për shumën 1.000 euro. Pa detyrim. Nuk është përdorur asnjëherë.

12.1 Për këtë marrëveshje subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Marrëveshjen për përdorimin e kartës individuale të kreditit, Master Card, me “Raiffeisen Bank”, nënshkruar nga znj. Manjola Kajana, në datën 17.3.2015, për shumën 1.000 euro.

12.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank””*.

- ✓ Nga hetimi administrativ rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me informacionin bankar të përcjellë me shkresën nr. (***)prot., datë 20.11.2018 nga “Raiffeisen Bank”.

13. Për deklarin në lidhje me kontratën e kredisë me kufi (overdraft) me “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Manjola Kajana, në datën 29.9.2015, për shumën 100.000 lekë. Pa detyrim. Nuk është përdorur asnjëherë.

13.1 Për këtë subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Kontratë kredie me kufi (overdraft), nënshkruar në datë 29.9.2015 ndërmjet znj. Manjola Kajana dhe “Raiffeisen Bank”, për shumën 100.000 lekë, shoqëruar me nxjerrje llogarie të pagës në emër znj. Manjola Kajana, për periudhën 1.1.2016 – 14.10.2016.

13.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank””*.

- ✓ Nga hetimi administrativ rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me informacionin bankar të përcjellë me shkresën nr. (***) prot., datë 20.11.2018 nga “Raiffeisen Bank”.

14. Për deklarin në lidhje me marrëveshjen për përdorimin e kartës individuale të kreditit, Master Card, me “Raiffeisen Bank”, në emër të z. K. K., lidhur në datën 23.9.2011, për shumën 1.500 euro. Shuma e detyrimit: 2.75 euro.

14.1 Për këtë subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Marrëveshje mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit, Master Card, nënshkruar në datë 19.9.2011, ndërmjet z. K. K. dhe “Raiffeisen Bank”, për shumën 1.500 euro, shoqëruar me fatura të kartës së kreditit për gjendjen e deklaruar në datën 31.3.2016.

14.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: *“Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka nuk përbën problem*

për kontrollin, pasi ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi i përket datës 31.3.2016, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 27.1.2017”.

14.3 Nga hetimi administrativ dhe nga verifikimi i dokumentacionit, Komisionit i ka rezultuar se: Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka është në një vlerë të papërfillshme, pasi kjo ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 29.02.2016, ndërsa data e deklaratës “Vetting” i përket datës 27.1.2017, për pasojë:

✓ Trupi gjykues arrin në konkluzion se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

➔ Deklarimi i pasurive të personit të lidhur, vjehrrit të subjektit

15. Për deklarimin në lidhje me pasurinë tokë arë, me sip. 1.470 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , ndodhur në: Rr.-G. . Burimi i krijimit: nga trashëgimia e babait, N. K. . Certifikata e pronësisë lëshuar në datën 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

15.1 Për këtë pasuri subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë tokë arë, me sip. 1470 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , vendndodhja: Rr.-G., Kavajë; në bashkëpronësi N. K., Th. K., Z. K., A. K., A. K., V. K. . Sipas ZVRPP-së kjo listë është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.
- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë.

15.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se:

Me certifikatën për vërtetim pronësie, datë 28.7.2005, të ZVRPP-së Kavajë²⁶, konfirmohet se shtetasi Th. K. është bashkëpronar në pasurinë tokë arë, me sip. 1470 m², regjistruar me nr. (***) , ndodhur në z.k. (***) , në Rr.-G., Kavajë, si rezultat i dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.

✓ Trupi gjykues, nga hetimi i kryer, arrin në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

16. Për deklarimin në lidhje me pasurinë tokë arë, me sip. 5350 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , ndodhur në: Rr.-G. . Burimi i krijimit: nga trashëgimia e babait, N. K. . Certifikata e pronësisë lëshuar në datën 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

16.1 Për këtë pasuri subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë tokë arë, me sip. 5.350 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , vendndodhja: Rr.-G., Kavajë; në bashkëpronësi N. K., Th. K., Z. K., A. Kajana, A. K., V. K. . Sipas ZVRPP kjo listë është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) datë 28.6.2005.

²⁶ Referojuni aneksit nr.4/20 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë.

16.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se:

Me certifikatën për vërtetim pronësie datë 28.7.2005, të ZVRPP-së Kavajë²⁷, konfirmohet se shtetasi Th. K. është bashkëpronar në pasurinë tokë arë, me sip. 5350 m², regjistruar me nr. (***) , ndodhur në z.k. (***) , në Rr.-G., Kavajë, si rezultat i dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.

- ✓ Trupi gjykues, nga hetimi i kryer, arrin në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

17. Për deklarinin në lidhje me pasurinë tokë arë me sipërfaqe 3060 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. nr(***) ; vendndodhja: Rr.-G. . Burimi i krijimit: nga trashëgimia e babait, N. K. . Certifikata e pronësisë lëshuar në datën 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

17.1 Për këtë pasuri subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë tokë arë, me sip. 3.060 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , vendndodhja: Rr.-G., Kavajë, në bashkëpronësi N. K., Th. K., Z. K., A. K., A. K., V. K. . Sipas ZVRPP-së kjo listë është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.
- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë.

17.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se:

Me certifikatën për vërtetim pronësie datë 28.7.2005, të ZVRPP-së Kavajë²⁸, konfirmohet se shtetasi Th. K. është bashkëpronar në pasurinë tokë arë me sip. 3060 m², regjistruar me nr. (***) , ndodhur në z.k. (***) , në Rr.-G., Kavajë, si rezultat i dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.

- ✓ Trupi gjykues, nga hetimi i kryer, arrin në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

18. Për deklarinin në lidhje me Pasuria tokë arë me sip. 840 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , ndodhur në: Rr.-G. . Burimi i krijimit: nga trashëgimia e babait, N. K. . Certifikata e pronësisë lëshuar në datën 28.7.2005. Në bashkëpronësi sipas listës.

18.1 Për këtë pasuri subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Çertifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë tokë arë, me sipërfaqe 840 m², regjistruar me nr. (***) , vol. (***) , vendndodhja: Rr.-G., Kavajë; në bashkëpronësi N. K., Th. K., Z. K., A. K., A. K., V. K. . Sipas ZVRPP-së kjo listë është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.
- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë.

18.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se:

Me certifikatën për vërtetim pronësie datë 28.7.2005, të ZVRPP-së Kavajë²⁹, konfirmohet se shtetasi Th. K. është bashkëpronar në pasurinë tokë arë, me sipërfaqe 840 m², regjistruar me

²⁷ Referojuni aneksit nr.4/21 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁸ Referojuni aneksit nr. 4/22 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁹ Referojuni aneksit nr. 4/23 në dosjen e ILDKPKI-së.

nr. (***) , ndodhur në z.k. (***) , Rr.-G., Kavajë, si rezultat i dëshmisë së trashëgimisë nr. (***) , datë 28.6.2005.

✓ Trupi gjykues, nga hetimi i kryer, arrin në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

19. Për deklarin në lidhje me gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar. Burimi të ardhura dhe kursime nga pensioni i pleqërisë. Vlera: 40.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

19.1 Për këtë deklarin subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka paraqitur:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, lëshuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, për punësimin e z. Th. K. gjatë periudhës janar 2008 – janar 2014. Të ardhurat e realizuara: 3.002.199 lekë.
- Vërtetim nr. (***) , datë 20.1.2017, nga ISSH-ja Durrës, për z. Th. K., i cili përfiton pension pleqërie prej datës 20.1.2014, në vlerën: 25.769 lekë/muaj. Totali i të ardhurave të përfituara në shumën: 915.691 lekë.
- ✓ Trupit gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me përfitimin e të ardhurave nga personi tjetër i lidhur i subjektit të rivlerësimit si i punësuar në shtet apo me statusin e pensionistit, i rezulton se personi i lidhur ka të ardhura të ligjshme për të justifikuar gjendjen *cash*.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “**DSIK**”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, përmes verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. (***) prot., datë 30.10.2017 të DSIK-së, të deklasifikuar me vendimin nr. (***) , datë 14.5.2019, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar se:

➔ Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, **DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit**, znj. Manjola Kajana;

➔ Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka hartuar raportin nr. (***) prot., datë 23.4.2019 për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Ky raport është bazuar: në formularin e vetëdeklarimit; në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; në 5 dosjet hetimore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; në të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë. Nga analiza e Këshillit të Lartë i Prokurorisë mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga analizimi

i të dhënave në 8 dosjet, referuar neneve 71–76 të ligjit të statusit për kriteret e vlerësimit, ky institucion për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit ka parashtruar se në lidhje me:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo bën referim të saktë dhe të drejtë në normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi analizon normën penale të zbatueshme, në raport me faktet dhe provat, duke bërë referime dhe në ligje të tjera që kanë lidhje me çështjen konkrete.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet, kërkesat, dhe aktet e tjera të përpiluar prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton përgjithësisht mirë rregullat e drejtshkrimin dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit procedural të prokurorit. Struktura e dokumenteve ligjore të saj u konstatua e qëndrueshme, mirëorientuar dhe e standardizuar, bazuar në formularët standard në nivel prokurorie. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe analizon në tërësi rrethanat e faktit. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti u ka kushtuar rëndësi analizës së normave ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Rezulton se nga prokurorja është përballuar ngarkesa e punës, duke mos krijuar zvarritje apo zgjatje të panevojshme të hetimeve.

Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësi në organizimin e punës dhe respektim i afateve hetimore dhe përpjekje për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen. Nga aktet e analizuar nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje të qëllimshme në kryerjen e veprimeve hetimore apo në kalimin për veprim të tyre të shërbimet e policisë gjyqësore, që ka çuar edhe në zgjidhjen e tyre sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, është eficient dhe efektive në drejtim të kohës së hetimit. Në pjesën më të madhe të çështjeve të ndjekura prej saj, hetimet kanë përfunduar në afate të arsyeshme.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet veprimet dhe procedurat e subjektit të rivlerësimit në kuadër të procedimeve penale dhe të materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme e duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve hetimore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Nuk paraqiten mungesa në përmbajtjen formale të akteve, si data, nënshkrimi

i pjesëmarrësve në të. Në fashikuj përfshihen të gjithë aktet që i përkasin çdo çështjeje konkrete, përfshirë dhe vendimet e gjykatës apo ankimet për vendimet.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, prokurorja përmbush me besnikëri disiplinat dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Manjola Kajana. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i saj nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim i tyre. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave.

C/I RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

- ✓ Komisioni, gjatë analizimit të këtij raporti, nga vlerësimi i tre dosjeve të përzgjedhura dhe i katër dosjet e përzgjedhura me short, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

Komisionit i rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit ishin depozituar dy kallëzime si më poshtë vijon:

- Në lidhje me kallëzimin e bërë në vitin 2017, nga shtetasi T. D. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndaj subjektit të rivlerësimit, për veprën penale “shpërdorimi detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilën është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal nr. (***) , i vitit 2017:

✓ Rezulton se procesi penal vijon të jetë në ndjekje të rrugës gjyqësore dhe, për pasojë, Komisioni, bazuar në pikën 2, të nenit E, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk mund të shtrijë vlerësimin ndaj hetimit të bërë lidhur me këtë kallëzim.

- Në lidhje me kallëzimin e regjistruar në datë 12.9.2017 pranë organit të kësaj prokurorie, lidhur me veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, i prokurorëve dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal, të depozituar nga shtetasja V.S.:

✓ Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika apo element dyshimi mbi veprimtarinë e punës së subjektit të rivlerësimit.

Po ashtu, nga të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, sikurse është pasqyruar edhe në raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisionit nuk i kanë rezultuar ankesa të asnjë natyre dhe as masa disiplinore, të përfunduara apo në fuqi.

Edhe nga verifikimet në Zyrën e Informacionit të Klasifikuar, si dhe Drejtorinë e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në 23 prokuroritë e shkallës së parë, Komisionit, sikurse edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk i rezultoi të ketë të dhëna që kanë të bëjnë me indice apo të dhëna të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillim hetimesh, për përfshirje drejtpërdrejt apo indirekt në veprime të dyshimta etj.

Po ashtu, për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, në adresë të Komisionit nuk rezultoi të jenë depozituar denoncime sipas parashikimeve të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

- Komisionit, nga studimi i fashikullit hetimor që i përket procedimit penal nr. (***), të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, hetimet e të cilit ishin pushuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 27.7.2015, i ka rezultuar se:

- Çështja ishte referuar në organin e prokurorisë në datën 18.11.2014, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, (në nivel sekret) Sektori për Krimin Ekonomik e Financiar për veprën penale “Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor”, “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 260–259, 245/1 të Kodit Penal.

- Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, duke përfshirë edhe përgjimet nëpërmjet personit të simuluar, subjekti i rivlerësimit kishte vendosur pushimin e kësaj çështjeje në datën 27.7.2015.

- Nga analizimi i kësaj çështjeje, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dukej se nuk kishte kryer disa veprime hetimore, për të cilat i kërkoi të japë shpjegime.

- **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni:**

Ndër të tjera subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se procedimi penal nr. (***) i vitit 2014 është regjistruar për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë apo të zgjedhurve vendor” parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, mbi bazën e informacionit për referimin e veprës penale të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë Tiranë. Duke e vlerësuar me rëndësi këtë referim, menjëherë pas regjistrimit të procedimit dhe disa verifikimeve të kryera nga policia gjyqësore, çështja është ndjekur duke përdorur mjete të kërkimit të provës, si vëzhgime në vende publike, përgjime telefonike për një periudhë pothuaj dymujore. Në të njëjtën kohë (duke qenë se policia ka kërkuar ndjekjen me veprime simuluese) çështja penale është ndjekur edhe me metoda të hetimit special, duke autorizuar një agjent të policisë gjyqësore për të kryer veprime simuluese me personin ndaj të cilit kishte indice se ishte përfshirë në veprimtari korruptuese me persona funksionarë të Komunës së Kasharit. Në rastin konkret, siç mund të konstatohet nga aktet e dosjes, nuk rezultoi në asnjë moment, që indicet e referuara nga policia gjyqësore të kishin marrë formë, drejt realizimit të veprimit korruptues.

- **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, **trupi gjykues** duke konsideruar se subjekti:

- kishte përdorur metodat speciale, si dhe ka kryer hetime proaktive, duke përfshirë edhe persona të simuluar, për të mundësuar kapjen në flagrancë të personave të dyshuar;

- kishte proceduar në momentin e duhur me veprime hetimore të hapura, pasi nuk ishin provuar elemente të aktit korruptues të çështjes;
- kishte kontrolluar ecurinë e përgjimit telefonik, për të cilat kishte zhvilluar disa herë analiza me oficerët e policisë gjyqësore;
- kishte kërkuar nga oficerët e policisë gjyqësore të relatohej rast pas rasti në lidhje me ecurinë e rezultateve të hetimit penal, *si dhe për faktin se* për vendimmarrjen e këtij procedimi penal drejtuesi i seksionit: (i) nuk kishte shprehur vërejtje, dhe (ii) kishte shprehur dakordësinë lidhur me zgjidhjen e çështjes, pasqyruar këto në procesverbalin e administruar në fashikullin penal;

çmon se veprimet hetimore të kryera nga subjekti janë bindëse dhe të ushtruara në përputhje me rolin dhe ushtrimin e detyrës së prokurorit.

- Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Lidhur me kriterin e pasurisë nën hetimin e thelluar e të gjithanshëm, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “Vetting” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri të plotë me deklaratimet periodike, si dhe të mbështetur në dokumentacion ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016.
- Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, në konsideratë të verifikimit e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë edhe, pas hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Për kriterin profesional, trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), vlerëson se subjekti ka përmbushur kushtet ligjore të pikës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimi, znj. Manjola Kajana, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe

publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi Komici

Kryesues

Lulzim Hamitaj

Anëtar

Brunilda Bekteshi

Relatore

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta